



Pranuar / Dorezuar Prilgeno/Prudato Received/Delivety	21.12.2022	2	Viti God Year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOPS HICK	8254	/2022	1/4



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.958/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.958/2022 të datës 28.10.2022, të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë banimi [redacted] kundër Vendimit me Nr.1008 të datës 04.10.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "ri-sistemim", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 21.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. *Aprovohet si e bazuar* ankesa A.nr.958/2022 e datës 28.10.2022 e parashtruar nga ankuesi: [redacted]
- II. *Anullohet* Vendimi Nr.1008 i datës 04.10.2022 i Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës.
- III. *Obligohet* Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të kthej ankuesin në pozitën e punës Udhëheqës për Menaxhimin e Parave Private të të Burgosurve sipas Akt-it të emërimit të datës 20.11.2018 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e tij e punës, si dhe të njëjtit t'i kompensoj diferencën e pagës së ndaluar nga data 04.10.2022 deri në zbatim të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] nëpunës civil në Shërbimin Korrektues të Kosovës, me datë 28.10.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 6516/2022 të regjistruar nën shenjen A.nr.958/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.1008 të datës

04.10.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës lidhur me ri sistemimin e ankuesit, me pretendimin ankimor se vendimi i goditur me ankesë është nxjerrë me shkelje të dispozitave të Ligjit për Zyrtarët Publike, Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura si dhe Ligjit për Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 11.11.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa ky i fundit më datë 16.11.2022 ka përcjell shkresat e lëndës lidhur me çështjen në procedurë.

Kryetari i Këshillit, bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin VK.nr.184/2022 të datë 07.12.2022 ka vazhduar afatin e vendimmarrjen lidhur me këtë çështje ankimore edhe për dhjetë (10) dite pune.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, administroi këto prova:* Ankesën me numër të protokollit 6516/2022 të datës 28.10.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me numër të protokollit 1008 të datës 04.10.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës; Vërtetimin me numër 24 të datës 01.03.2022 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; Përshkrimin e detyrave të punës të datës 04.06.2008 për pozitën "Udhëheqës për Menaxhimin e PPB"; Akt emërimit të datës 20.11.2018 për pozitën e punës "Udhëheqës për Menaxhimin e PPB-se"; Akt emërimit të datës 06.12.2017 për pozitën e punës " Udhëheqës për Menaxhimin e PPB-se"; Kontratën e punës të datës 01.08.2014 për kohë të pa caktuar për pozitën Udhëheqës për Menaxhimin e PPB-së"; Kontratën e punës të datës 01.08.2011 për pozitën "Udhëheqës i Menaxhimit të PPB-së"; Kontratën e punës të datës 01.08.2022" për pozitën e punës "Udhëheqës i Menaxhimit të PPB-se"; Kontratën e punës të datës 01.06.2008 për pozitën e punës " Udhëheqës i Divizionit të Burimeve Njerëzore"; Kontratën e punës të datës 01.04.2008 për pozitën e punës "Udhëheqës i Divizionit të Burimeve Njerëzore" ; Kontratën e punës të datës 01.01.2008 për pozitën "Udhëheqës i Divizionit të Burimeve Njerëzore" ; Kontratën e punës të datës 01.01.2006 për pozitën e punës "Drejtor" në Divizionin e Menaxhimit penal; Vendimin me numër të protokollit 1491 të datës 15.11.2018; Vendimin me numër të protokollit 1548 të datës 21.11.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës; Vendimin me numër 637 të datës 18.05.2018 të U.D Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës; Vendimin me numër të protokollit 1043 të datës 19.07.2017 të U.D të Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë të datës 31.01.2022; Formularin për vlerësimin e rezultateve të punës të datës 30.12.2020; Formularin për vlerësimin e rezultateve të punës të datës 20.12.2019; Mirënjohjen e datës 23.12.2015; Vendimin nën shenjen A.nr.922/2021 të datës 28.12.2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin nën shenjen A.nr.662/2022 të datës 19.09.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 7008/2022 të datës 11.11.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 7166/2022 të datës 16.11.2022; Vendimin nën shenjen VK.nr.184/2022 të datës 07.12.2022; Emalin e datës 20.12.2022 me numër të protokollit 8240/2022 të drejtuar Këshillit; Emalin e datës 20.12.2022 të drejtuar Këshillit; Pjesë të rregullores QRK-NR.31/2013 për Organizimin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë; Emalin e datës 20.12.2022 të A.Demiri drejtuar Këshillit të Pavarur; Aktin e Emërimit të datës 07.05.2012 për pozitën "Menaxhere për Buxhet dhe Financa".

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi së janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit, SEPSE:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton së ankuesi është i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, dhe se i njëjti sipas kontratës së punësimit 031/SHKK është emëruar në pozitën e punës *Udhëheqës i Menaxhimit të Parave Private të të Burgosur* në Drejtorinë Qendrore, e të cilën pozitë e ka ushtruar që nga data 01.08.2008 deri në nxjerrjen e Vendimit Nr.1008 të datës 04.10.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me të cilin vendim ankuesi është ri sistemuar nga pozita e punës *Udhëheqës i Menaxhimit të Parave Private të të Burgosurve*, me koeficient 9.5 të pagës, në pozitën e punës *Zyrtar i Lartë i PPB-së në Njësinë Për Buxhet dhe Financa dhe Menaxhimin e PPB*, Drejtoria e Përgjithshme, me koeficient të pagës tetë (8), me arsyetimin se Rregullorja QRK-Nr.31/2013 për Organizimin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë nuk parasheh Divizion për Menaxhimin e Parave Private të të Burgosurve, e as pozitë Udhëheqës për Menaxhimin e Parave Private të të Burgosurve.

Kundër Vendimit Nr.1008 të datës 04.10.2022 për ri sistemim, ankuesi me datë 28.10.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të shkëlqe të dispozitave të Ligjit për Zyrtarët Publike, Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura si dhe Ligjit për Shërbimin Korrektues të Kosovës Tutje, ankuesi pretendon se nuk ka pasur shuarje apo ristrukturim të institucionit, sepse Sektori i menaxhimit të Parave Private të të Burgosurve ende funksionon.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar Rregulloren QRK-Nr.31/2013 për Organizimin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.12.2013, dhe si rrjedhojë duke bazuar në nenin 41 paragrafi 3 të kësaj rregullore ka konstatuar se Drejtorati për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme përbëhet nga këta sektorë: Sektori i Burimeve Njerëzore; Sektori për Buxhet dhe Financa dhe Menaxhim të Parave Private të të Burgosurve, dhe; Sektori për Teknologji Informative, Inxhinieri dhe Shërbime Logjistike. Ndërlidhur me këtë, Kolegji bazuar në provat e lëndës ka konstatuar së pozita e Udhëheqësit të Sektorit për Buxhet dhe Financa dhe Menaxhim të Parave Private të të Burgosurve ushtrohet nga dy nëpunës civil përkatësisht nga ankuesi i emëruar nga data 01.08.2008 në pozitën e Udhëheqësit për Menaxhimin e Parave Private të të Burgosurve të si dhe nga znj. N. Kamberi e emëruar nga data 07.05.2012 në pozitën e Udhëheqëses së Divizionit për Buxhet dhe Financa.

Rrjedhimisht, nga shqyrtimi i prova të lëndës rezulton së Shërbimi Korrektues i Kosovës më hyrjen në fuqi të Rregullores QRK-Nr.31/2013 për Organizimin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë, nuk ka bërë sistemimin e ankuesit për shkak të ristrukturimit ashtu siç përcaktohej me dispozitat e Rregullores (QRK)-Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë gjegjësisht nenin 13 të kësaj rregullore me të cilin përcaktohej se: " Raste të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit do të konsiderohen ndryshimet e vendeve të punës rastet në të cilat, për efekt të shuarjes apo ristrukturimit të ndodhur në institucion: 1.1. janë shkurtuar vende pune; 1.2. janë ristrukturuar vende pune; 1.3. kanë ndryshuar kriteret e vendeve të punës. 2. Në rast se paraqiten rastet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, nëpunësit civilë sistemohen në vendet e reja të krijuara, të ristrukturuara apo të mbetura si pasojë e ristrukturimit apo shuarjes së institucionit, në të njëjtën kategori, në njërin nga institucionet e përcaktuara në Nenin 54. paragrafin 2 të Ligjit. 3. Nëpunësit e institucionit të ristrukturuar apo të shuar njoftohen individualisht nga Njësia e Burimeve Njerëzore për fillimin e procedurës së transferimit për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, menjëherë pas miratimit të aktit të ristrukturimit apo mbylljes së

*institucionit", respektivisht ankuesi në pozitën e Udhëheqësit për Menaxhimin e Parave Private të të Burgosurve si dhe znj. N. Kamberi në pozitën e Udhëheqëses së Divizionit për Buxhet dhe Financa, kanë qenë të emëruar në këto pozita para hyrjes në fuqi të Rregullores QRK-Nr.31/2013 për Organizimin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë, kështu që edhe sistemi i tyre si pasojë e ristrukturimit nuk është bërë deri me rastin e nxjerrjes së vendimit të kundërshtuar me ankesë.*

Po ashtu, Kolegji i Këshillit për vendosje meritore të kësaj çështje analizoi edhe dispozitat e Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës (i cili ka hyrë në fuqi me datë 24.08.2022), përkatësisht nenin 10 paragrafi 2 përcaktohet se: *2.Organizimi i brendshëm dhe funksionimi i Shërbimit Korrektues të Kosovës, rregullohet me akt nënligjor të nxjerrë sipas legjislacionit përkatës në fuqi, dhe nenin 68 të njëjtit ligj ku përcaktohet se: 1. Aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji, nxirren brenda një (1) viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji. 2.Deri në nxjerrjen e akteve nënligjore sipas këtij Ligji zbatohen aktet nënligjore në fuqi, me kusht që mos të jenë në kundërshtim me dispozitat e këtij Ligji,* kështu që, mbi ekzistimin e këtyre rrethanave të reja ligjore dhe duke qenë se pozita Udhëheqës i Sektorit për Buxhet Financa dhe Menaxhimin e Parave Private të të Burgosurve është e paraparë me Rregulloren QRK-Nr.31/2013 për Organizimin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë, Kolegji vlerëson se ankuesi ka të drejtë t'i ushtroj detyrat e punës sipas Aktit të Emërimit të datës 01.08.2008, deri në nxjerrjen e akteve nënligjore siç përcaktohet me dispozitat e nenit 10 paragrafi 2 të Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, rrjedhimisht deri në nxjerrjen e rregullores për organizim të brendshëm të SHKK dhe përfundimin e procesit të sistematizimit të vendeve të punës.

Bazuar si me sipër Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimi ankimor i ankuesi për shkelje të ligjit material nga organi i punësimit me rastin e ri sistemimit të tij nga pozita e punës Udhëheqës për Menaxhimin e Parave Private të të Burgosurve, me koeficient të pagës nëntë pikë pesë (9.5), në pozitën e punës *Zyrtar i Lartë i PPB-së në Njësinë Për Buxhet dhe Financa dhe menaxhimin e PPPB,* Drejtoria e Përgjithshme, me koeficient të pagës tetë (8), është i bazuar dhe i drejtë, ndërsa Vendimi Nr.1008 i datës 04.10.2022 është i paligjshëm në kuptim të dispozitave të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Andaj, duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.958/2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-Dëmi

Kryetare e Kolegjit

### Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së